



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 845/3 Prot.

Fier, më 23.08. 2021

THIRRJE E VECANTË 7

E VENDEVE TË LIRA ME AFAT TË CAKTUAR PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, VKM nr.99 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njesisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, si dhe bazuar në kërkesën e ZVAP Selenicë datë 19.08.2021, shpall 2 vendet e lira të punës me afat të caktuar, për punonjës të shërbimit psiko-social si më poshtë:

ZVAP Selenicë në shkollat:

1- "Filo Ramadani" Armen dhe mbulon shkollat:

Todi Koceli
Hajredin Beqari
Filo Ramadani
Razip Sadikaj
Ali Asllani
Qazim Sina
Mynyr Xhindi

2- "Eqerem Beqiri" Kotë dhe mbulon shkollat:

Laze Nuro
Hamdi Rrapi
Qani Nuredini
Eqerem Beqiri
Haki Bylyshi
Deshmoret e Peshkepise
Sadik Zotaj

I. Kriteret për tu punësuar në shërbimin psikosocial

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;

4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim janë:

1. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të parë, në fushën përkatëse (nëse ka të përfunduar edhe ciklin e dytë përbën avantazh për kandidatin)
2. Njohuri bazë në kompjuter;
3. Aftësi komunikuese dhe të punës në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);
4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës Bachelor , vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta të ciklit të parë Bachelor (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar e ciklit master (nëse ka master).
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave .
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (detyrueshme).

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier përkatëse brenda afatit 23.08.2021- 31.08.2021.

III. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet nga komisioni i DRAP Fier.

IV. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjek procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020.

DREJTORI

BRUNILDA DHAMO

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Gazmira Birçaj

